



Pranimar / Dorezuar Primijseni / Prodato Received / Delivery	28.12.2021	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSTICK	6372	2021	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.959/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malësore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1424/20, të datës 19.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me datë 24.11.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 175/2020 të datës 26.06.2020 të parashtruar nga ankuesja të cilën e përfaqëson me autorizim avokati rruga "Gjergj Fishta" nr.22 Lipjan, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e papabuzuar** ankesa me numër A.nr.175/2020 e datës 26.06.2020 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi** Vendimi me numër protokoll 03/02-129/20 i datës 06.04.2020, i Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, me datë 26.06.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1235/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 03/02-129/20 të datës 06.04.2020 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës, i pranuar nga ankuesja me datë 18.06.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijen e Ankesave, më datë 01.07.2020 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Policinë e Kosovës, ndërsa me datë 15.07.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 29.07.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës si dhe duke e udhëzuar se mund ti ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund ta filloj procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 24.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1424/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 29.07.2020 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr.175/2020 të datës 26.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritorie ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1235/2020 të datës 26.06.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 29.07.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2020; Autorizimet e datës 06.12.2021 për ankuesit; Autorizim i datës 20.08.2020; Vendim për sistemim për kohë të pacaktuar i datës 03.12.2019; Ankesë kundër njoftimit të Drejtorisë së Personelit lidhur me përmirësimin e koeficientit dhe kompensimin e diferencave në koeficient për tri (3) vite në mënyrë retroaktive i datës 06.03.2020; Ankesën e ankueses të datës 23.12.2019; E-mailin e datës 21.02.2020; Vendim i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës me nr. 03/02-129 i datës 06.04.2020; Konkurs me nr. Reference 07/1-01R/06/19; Konkurs me nr. Reference 07/1-01R/02/18; Konkurs me nr. Reference 07/1-01R/04/17; Përgjigje në ankesë e datës 15.07.2020; Kontratë pune për kohë të caktuar/pacaktuar (stafi civil) e datës 03.04.2017; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 04.09.2015; E-mailin e datës 05.12.2018; Kartela e nëpunësit civil; E-mail nga F.A. Përgjigje në ankesë; E-mailin e datës 13.01.2020; Udhëzim Administrativ Nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës; Rregullore (MPB) Nr.02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës; Struktura Organizative e datës 31.01.2017; E-mail nga C.Z. për F.A. i datës 02.12.2021; E-mail nga D.D. për C.Z. i datës 03.12.2021; E-mail nga F.A. për T.M. i datës 13.02.2021; Vendim i Komisionit për Ankesa i Policisë së Kosovës me nr. 03/02-40 i datës 28.01.2020; Aktgjykim me numër A.nr.1424/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 24.11.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar Aktgjykimin me numër A.nr. 1424/2020 të datës 24.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e pa bazuar, ***sepse:***

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja sipas Kontratës së Punës së datës 03.04.2017, ka ushtruar detyrën e punës “Zyrtar për Përkthime”, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, me pagë baze e shprehur në vlerë prej 407,55 Euro, ndërsa me Vendimin me Nr. reference 07/1-01SAP-P/10550 të datës 03.12.2019, ankuesja është sistemuar për kohë të pacaktuar në pozitën e punës “Zyrtar për Përkthime (Shqip – Serbisht dhe anasjelltas)”, në Drejtorinë e Personelit, me pagë baze të shprehur në vlerë monetare 423.85 Euro, dhe shtesa 25.00. Euro. E pakënaqur me këtë vendim ankuesja me datë 23.12.2019 parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, më kërkesën që të anulohet Vendimi për sistemim të përkohshëm i datës 03.12.2019 ose i njëjti të rishqyrtohet ashtu që ankueses ti aprovohet koeficienti i pagës në nivelin Zyrtar i Lartë për Përkthime dhe ti kompensohet për tri vite diferenca e koeficientit në mënyrë retroaktive.



Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës, me Vendimin me numër protokoll 03/02-40 të datës 28.01.2020 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankueses dhe lëndën e ka rikthyer në rishqyrtim tek Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës.

Drejtorja e Personelit me datë 21.02.2020, ka njoftuar ankuesen se në zbatim të Vendimit të Komisionit të Ankesave ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike që të aprovoj koeficientin e pagës të njëjtë me pozitë të njëjtë në institucionet tjera të shërbimit civil, duke shtuar se derisa sa nuk ka aprovim nga kjo Ministri përgjegjëse, Policia e Kosovës nuk mund të vendos lidhur me ndryshimin e koeficientit.

Ankuesja sërish më datë 06.03.2020, parashtron ankesë në Komisionin e Ankesave të Policisë së Kosovës, i cili me Vendimin me numër protokoll 03/02-129/20 i datës 06.04.2020 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Bazuar në dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil*, ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: *Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës*, Kolegji ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Andaj, mbi këtë bazë ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja e realizon pagën sipas kontratës së punës respektivisht Vendimit të datës 03.12.2019 për sistemim për kohë të pacaktuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon për harmonizim të koeficientit si të nëpunësve të nivelit qendror dhe kompensim retroaktiv të koeficientit për tri vite, ka konstatuar që Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës ka bërë përpjekje të nevojshëm për harmonizim të koeficienteve ku më datë 05.12.018 kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike që të bëhet klasifikimi i vendeve të punës për stafin civil në Policinë e Kosovës, ndërsa pas Vendimit me Nr.03/02-33 të datës 28/01/2020 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës më të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e ankueses dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Personelit e Policisë së Kosovës më datë 13.02.2020 ka dërguar kërkesë për harmonizim të koeficienteve për pozitat e shërbyesve civil në Policinë e Kosovës tek Ministria e Administratës Publike por nuk ka marr përgjigje lidhur me këtë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Policia e Kosovës ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për harmonizim të koeficienteve siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr. 33/20120 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, pasi që në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe kësaj rregulloreje, përcaktohet që *"grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa"* neni 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, si rrjedhojë harmonizimi i koeficienteve bëhet nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa, në këtë kuptim Policia e Kosovës duhet të bëjë vetëm planifikimin për harmonizim të koeficienteve veprim të cilin e ka ndërmarrë me rastin e kërkesës së datës 05.12.018 të cilët kanë kërkuar nga Ministria e Administratës Publike, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar, ngase ngritja e koeficientit nuk është në kompetencë të Policisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.03/02-133/20 i datës 06.04.2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 959/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuases avokatit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtares Lirije Maksutaj
- Drejtorit të Drejtorisë së Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

